



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SHKENCËS
DREJTORIA E ZHVILLIMIT TË KURRIKULËS**

**MIRATOHET
MINISTRI**

Luan MEMUSHI

**PROGRAMI I LËNDËS
SË GJUHËS ITALIANE**

KLASA III

CIKLI FILLOR I SHKOLLËS 9-VJEÇARE

Tiranë, 2005

PËRMBAJTJA E PROGRAMIT

- I. HYRJE

- II. SYNIMET EDUKATIVE DHE OBJEKTIVAT DIDAKTIKË

- III. METODOLOGJIA E VLERËSIMIT DHE VETËVLËRËSIMIT

- IV. PËRSHKRIMI I AFTËSIVE GJUHËSORE

- V. STRUKTURA ANALITIKE E PROGRAMIT
 - AKTET / FUNKSIONET KOMUNIKUESE
 - TEMATIKA
 - STRUKTURAT GRAMATIKORE

- VI. UDHËZIME DIDAKTIKE

- VII. STRUKTURA SINTETIKE E PROGRAMIT

- VIII. KRITERET PER HARTIMIN E TEKSTIT

I. Hyrje

Mësimi të italishtes në klasën e tretë të arsimit 9-vjeçar i është caktuar një sasi prej 70 orësh mësimore, pra me 2 orë në javë.

Në përgatitjen e këtij programi është mbajtur parasysh Kurrikula kombëtare e gjuhëve moderne për arsimin parauniversitar, 2000, “Vizioni kurrikular-2004”, si dhe Kuadri i përgjithshëm i Referencave të Këshillit të Evropës (1998);

Programi përbëhet nga dy pjesë: e para, kryesore, është konceptuar sipas të gjithë parametrave e një teorie kurrikulare dhe i përmban të gjithë komponentët e nevojshëm kurrikularë; pjesa e dytë ka të bëjë me strukturën sintetike të programit, me ndarjen e orëve mësimore në klasë.

Ky program e ka përqendruar vëmendjen e vet kryesisht te funksion emotiv apo vetjak, si edhe shoqëror që synojnë të integrohen me mjedisin përreth fëmijëve përgjatë pjesës më të madhe të ditës.

Qoftë nocionet e përgjithshme, qoftë ato të veçanta për të cilat është konceptuar i tërë programi, dhe për rrjedhojë i tërë kursi gjuhësor, mbajnë parasysh moshën e nxënësve me karakteristikat përkatëse. Për këtë arsye janë lënë mënjane tema dhe nocione që ata nuk i njohin ende edhe pse shpesh janë të ekspozuar ndaj burimesh të ndryshme mediatike.

II. Synimet edukative dhe objektivat didaktikë

Mësimdhënia/nxënia e gjuhës italiane në shkollën fillore, ashtu si edhe mësimi i gjuhëve të tjera, ndihmon në formimin e përgjithshëm të nxënësit; zgjeron aftësitë e tij shprehëse, ofron modele të të sjellurit në situata të caktuara mësimore; ndihmon përfshirjen e nxënësit në shkëmbime të shumëllojshme.

Mësimi i një gjuhë të huaj njëkohësisht është dhe proces njohjeje i kulturës së atij populli që e flet atë dhe si i tillë bëhet i mundur një zgjerim i horizontit kulturor dhe njohës të nxënësit duke kontribuar kështu drejtpërdrejt në formimin e personalitetit të tij.

Të mësosh gjuhën e huaj do të thotë, me fjalë të tjera, të mësosh të respektosh dhe të tolerosh tjetrin, me ato dallime që e karakterizojnë atë, do të thotë të fitosh sensin e relativitetit dhe shpirtin e tolerancës.

Mësimi i gjuhës së huaj bart me vete një ndërgjegjësim gjithnjë në rritje mbi sistemin gjuhësor dhe mbi funksionimin e gjuhës; ky është një proces i vazhdueshëm i cili ecën përpara duke u përmirësuar vazhdimisht përgjatë jetës.

I tërë procesi i mësimdhënies/nxënies së gjuhës së huaj në shkollën fillore është i konceptuar si një veprimtari-lojë, si veprimtari argëtuese, si veprimtari motore dhe psikomotore, edhe si veprimtari krijuese me kah komunikimin, shprehjen, punën me tingujt, fjalët dhe frazat; nxënësi i kësaj moshe rritet përmes veprimit dhe kontaktit të vazhdueshëm me mjedisin fizik rrethues, duke prekur, duke perceptuar, duke ndjerë fizikisht.

Programi i gjuhës së huaj në shkollën fillore synon zhvillimin e proceseve kognitive, trainimin e mendjes, krijimin e aftësive njohëse dhe krijuese; mbi të gjitha ajo synon tu mësojë nxënësve të ashtuquajturin ‘ëay of learning’, të mësojnë se si mësohet.

Objektivi kryesor është arritja nga ana e nxënësit në përfundim të kursit të aftësisë kuptimore dhe shprehëse, kryesisht gojore, aftësi e cila do t’i lejojë atij të kryejë në gjuhë të huaj funksionet komunikuese bazë, të cilat i has në situatat më të shpeshta të jetës së tij. Situata të tilla u përkasin interesave dhe përvojës që karakterizojnë moshën e nxënësit.

III. Vlerësimi / vetëvlerësimi

Mbi bazën e qasjes glotodidaktike të përshtatur, edhe faza e verifikimit të arritjes së objektivave dhe e vlerësimit të aftësive përqendrohet mbi të kuptuarit dhe të prodhuarit gojor; aftësitë me shkrim të vlerësohen përmes veprimtarive si më poshtë:

- kopjimit të fjalëve apo frazave të shkurtra,
- plotësimin të vendeve bosh brenda fjalëve apo frazave të shkurtra,
- përdorimit të batutave të shpeshta në një dialog të shkurtër,
- përgatitja e mesazheve të urimit, listave të thjeshta me rroba, ushqime, sende të klasës apo të shtëpisë.

IV. Përshkrimi i aftësive gjuhësore (performanca gjuhësore)

Duke iu referuar kuadrit të përgjithshëm të Kurrikulës së gjuhëve moderne, performanca e përgjithshme e nxënësit të klasës së tretë fillore do të përshkruhet sipas standardeve të mëposhtme, të përshkruara sipas aftësive të veçanta:

Të dëgjuarit

Nxënësit reagojnë përmes veprimesh fizike ndaj instruksioneve dhe komandave të mësuesit;

Ata kuptojnë tekste të shkurtra, të shoqëruara me figura apo vizatime apo gjeste të mësuesit;

Ata dëgjojnë dhe kuptojnë fraza të thjeshta të shqiptuara qartazi e me një shpejtësi të reduktuar.

Të folurit

Nxënësit shqiptojnë fjalë dhe fraza të thjeshta apo të shkurtra në mënyrë të saktë, me një shpejtësi pothuaj normale;

Ata bëjnë pyetje të thjeshta rreth çështjesh të ndryshme, kërkojnë informacion, u përgjigjen pyetjeve e kërkesave të thjeshta të bëra nga ana e nxënësve të tjerë apo nga mësuesi rreth çështjesh që i përkasin sferës së interesave dhe nevojave të tyre.

Të lexuarit

Nxënësit kuptojnë tekste të shkruara që përmbajnë fjalë specifike dhe fraza të shkurtra me një fjalor të njohur;

Ata lexojnë me zë të lartë fjalë specifike dhe fraza të shkurtra të njohura apo të mësuara me parë përmes kanaleve të tjera shqisore;

Ata demonstronë se i kuptojnë dialogjet e thjeshta e të shkurtra rreth çështjesh specifike.

Të shkruarit

Nxënësit kopjojnë fjalë të veçanta, fraza të shkurtra të njohura më parë;

Ata zëvendësojnë me shkronja të veçanta boshllëqet brenda fjalës apo boshllëqet brenda frazës duke zgjedhur ndërmjetfjalëve të tjera të renditura në formën e një liste.

V. Struktura analitike e programit

1. Aktet / funksionet e komunikimit

Duke patur parasysh nevojat komunikuese të nxënësve, si edhe synimet pedagogjik-edukative të sistemit shkollor shqiptar, janë përcaktuar, për këtë nivel, për secilën situatë, një sërë aktesh / funksionesh komunikuese, të cilat, për nga pesha dhe për nga shkalla e përdorimit, janë ndarë më të rëndësishmet dhe atyre u përgjigjet një strukturë gramatikore dhe një fushë e caktuar semantiko-leksikore. Prandaj, këtu më poshtë jepet një tabelë në të cilën, për secilën njësi didaktike, janë përcaktuar nocionet, aktet e komunikimit, strukturat gramatikore dhe leksikore:

1. Të takojnë dikë e të njihen /paraqiten me të:
 - 1.1. Të paraqiten e t'i përgjigjen një paraqitjes;
 - 1.2. Të paraqesin persona të tjerë;
 - 1.3. Të kërkojnë e të përgjigjen për emrin dhe mbiemrin;
 - 1.4. Të kërkojnë e të përgjigjen për moshën;
 - 1.5. Të kërkojnë e të përgjigjen për numrin e telefonit.

2. Të marrin pjesë në një bisedë me karakter të përgjithshëm:
 - 2.1. Të përshëndetin e t'u përgjigjen përshëndetjeve;
 - 2.2. Të falenderojnë e t'u përgjigjen falenderimeve;
 - 2.3. Të kërkojnë e të japin informacione përmbi shëndetin;
 - 2.4. Të tregojnë objekte dhe persona;
 - 2.5. Të kërkojnë dhe të japin objekte, t'i pranojnë apo t'i refuzojnë ato;
 - 2.6. Të bëjnë ftesa, t'i pranojnë apo t'i refuzojnë ato
 - 2.7. Të kërkojnë e të përgjigjen për çka dinë të bëjnë (gjuhët, sportet, instrumentet muzikore);
 - 2.8. Të kërkojnë leje, ta pranojnë apo ta refuzojnë atë;
 - 2.9. Të shprehin kënaqësi apo moskënaqësi;
 - 2.10. Të kërkojnë e të japin informacione për kohën;
 - 2.11. Të kërkojnë e të thonë datën;
 - 2.12. Të kërkojnë e të shprehin opinione të thjeshta rreth personash, objekteve, vendesh apo ngjarjesh;
 - 2.13. Të shprehin pëlqim apo mospëlqim.

3. Të marrin pjesë aktive në një ndërveprim në mjedis publik:
 - 3.1. Të tërheqin vëmendjen e dikujt;
 - 3.2. Të kërkojnë e të thonë vendndodhjen e objekteve të ndryshme;
 - 3.3. Të kërkojnë për një mall apo send në dyqan a gjetkë;
 - 3.4. Të pyesin për çmimin dhe vlerën.

4. Të dinë të përdorin mjetet e komunikimit:
 - 4.1. Të hapin e të mbyllin një bisedë telefonike.

2. Tematika

Janë përzgjedhur këto sfera tematike apo nocione, të cilat përfaqësojnë interesat dhe nevojat komunikuese të nxënësit të kësaj moshe:

1. Jeta e përditshme:

- familja, të afërmit;
- shtëpia, mjediset e brendshme, objektet apo sendet në të, llojet e banesave;
- ngjyrat;
- pjesët e trupit;
- lodrat e ndryshme;
- veshja.

2. Shkolla:

- shkolla, objektet përreth saj;
- klasa, objektet dhe sendet në të;
- shokët dhe shoqet e grupit.

3. Bota përreth:

- koha, ndarja e kohës;
- zyrat publike;
- tregu, dyqanet, monedhat;
- spitali, shëndeti;
- kafshët.

4. Numrat:

- veprime me numrat.

3. Elemente dhe struktura gramatikore

Vetat, njëjësi dhe shumësi,
Shumësi i emrave,
Nyjet shquese *il, la, le, i, gli*,
Format e kohës së tashme dëftore,
Tri zgjedhimet e rregullta në të tashmen e dëftores,
Forma pohore, mohore, pyetëse,
Gjinia e emrave,
Mbiemrat dëftorë *questo, quello*,
Pronorët, njëjës e shumës,
Forma të mënyrës urdhërore,
Përdorimi i formës së mirësjelljes përmes kushtores,
Folje ndihmëse: *essere, avere*,
Folje që tregojnë veprime apo gjendje të përditshme, si: *chiudere, aprire, andare, venire, guardare, ascoltare, salutare, presentarsi, prendere, lasciare, dormire, starnutire, correre, annusare, disegnare, colorare* etj.

VI. Udhëzime didaktike

Tematika e librit është konceptuar si një bashkësi skedash, të cilat mësuesi mund t'i përdorë apo t'i organizojë sipas një renditjeje të përshtatshme në shërbim të këndvështrimit të vet dhe në varësi të kushteve të klasës apo të nxënësve, me të cilët po punon.

Një mundësi me karakter metodologjik lidhet me parimin sipas të cilit nuk mund të realizohet të nxënit pa pjesëmarrjen aktive të nxënësit. Për të nxitur këtë pjesëmarrje, të përdoren veprimtari në të cilat të ndërfitet sa më shumë të jetë e mundur nxënësi. P.sh., për të zhvilluar bisedën, do të ishte më mirë që në vend që të përdreshin figurat apo vizatimet e librit, të bëhej referim konkret tek sendet e pranishme në klasë apo t'u kërkohet vetë nxënësve që të sillnin nga shtëpia disa sende apo objekte që lidhen me temën përkatëse.

Për të ngjallur motivimin dhe pjesëmarrjen e nxënësve të përdoren sa më shumë lojëra, teknika dramatizimi e veprimtari zbavitëse. Loja i krijon mundësi përfshirjeje fizike dhe emotive nxënësit në veprimtari në grup dhe i krijon mundësi atij të dalë jashtë mjedisit shkollor, duke shkarkuar tensione, frustrime e duke shmangur filtrin afektiv bllokues, si edhe të nxjerrë në pah personalitetin e vet. Dramatizimi i krijon mundësi pjesëmarrjeje përmes dialogjeve në shkëmbime me karakter komunikues, të cilat lypin kryerjen e një roli të caktuar në një mjedis të përcaktuar. Qoftë loja, qoftë dramatizimi bëjnë të mundur përdorimin e disa kanaleve shprehëse për komunikimin: fjalën, veprimin, gjestin.

Në fazën e paraqitjes së materialit gjuhësor lipset që, përmes shoqërimit me një objekt konkret, me një figurë, një tingull, një gjest apo një veprim, të bëhet i mundshëm kuptimi i domethënies së një fjale apo një shprehjeje.

Për shpjegimet e ndryshme, për të paraqitur një lojë apo një veprimtari praktike, mësuesi të përpiqet të jetë sa më i qartë e i kuptueshëm. Për këtë arsye, ai duhet të jetë i sigurt që nxënësit e tij janë në gjendje ta kuptojnë e ta ndjekin atë kur ai flet italisht, por kur ai dallon se moskuptimi shkakton edhe një moskryerje normale të veprimtarisë që paraqet, atëherë nuk duhet të hezitojë të përdorë gjuhën amtare duke përdorur shprehje, si: “ta zëmë se...”, “të marrim me mend se...” etj.

Pas paraqitjes së veprimtarisë apo të lojës, të fjalëve apo strukturave të reja, mësuesi, nga roli fillimisht i aktorit të tërhiqet e të kalojë në rolin e regjizorit që drejton aktorët (nxënësit), duke i nxitur ata e duke dhënë *input*-e apo skena të reja.

Gjuha e përdorur në klasë është ajo bashkëkohore, në formën, ritmin dhe intonacionin e vet autentik. Të nxënit e shqiptimit dhe të intonacionit të saktë lehtësohet nga përdorimi i rregullt i gjuhës italiane, të poezive apo këngëve në klasë, si edhe përmes ndjekjes së programeve televizive jashtë saj.

Llojshmëria e teknikave didaktike do të bëjë të mundur përfitimin e të gjithë nxënësve, duke patur parasysh faktin se aftësitë e tyre nuk janë të njëjta apo të barabarta. Lipset puna me grupe, skuadra apo çifte në brendësi të të cilave të mos lejohet monopolizimi vetëm nga ana e 1-2 nxënësve më të mirë, por t'u jepet mundësia të gjithëve të marrin pjesë. Mësuesi i nxit të gjithë që të shprehen lirisht.

Reflektimi gjuhësor duhet të jetë:

-induktiv dhe konkret (është nxënësi ai që, duke ndjekur mënyrën induktive, zbulon rregullën përmes veprimtarish konkrete gjuhësore);

-i paraqitur në formë loje apo problemi për zgjidhje, i tillë që të nxitë nxënësit të vënë në përdorim aftësitë e veta vëzhguese;

-jo i bazuar mbi një metodologji të përqendruar në shpjegimin e rregullës nga mësuesi, por që synon në zbulimin e saj nga vetë nxënësit natyrisht të ndihmuar edhe nga mësuesi.

Veprimtaritë e paraqitura në libër të pranohen e të trajtohen më shumë si një material referues dhe imput për një veprimtari më të thelluar nga secili mësues në mënyrë autonome, duke përpunuar materiale, teknika apo tekste e modele sipas shembullit të vet librit apo edhe thjesht, duke iu referuar programit. Kur niveli i nxënësve të klasës së tretë, për arsye e shkaqe të ndryshme, është më i lartë se niveli i përcaktuar në këtë program, atëherë, për të mos shkaktuar demotivim, si edhe për të shmangur monotoninë, mësuesi mund të propozojë e t'u paraqesë nxënësve të tij materiale të tjera gjuhësore, të zgjedhura e të përgatitura nga vetë ai, duke i integruar me materialin e tekstit të gatshëm, duke ndjekur kërkesat e mëposhtme:

- të sigurojë natyrshmërinë e gjuhës së paraqitur;
- të sigurojë përshtatshmërinë e gjuhës me situatën dialogjike;
- të kufizojë strukturat dhe leksikun e ri të paraqitur;
- të ketë parasysh që gjatësia e tekstit të dhënë të jetë e mjaftueshme për të kontekstualizimin e formave të reja që të bëhet kështu i mundshëm një kuptim dhe një dramatizim i thjeshtë i tekstit;
- të paraqesë një farë shkalle interesi për nxënësit;
- të përdorë mjete vizive ndihmëse (objekte, pamje, fotografi, revista etj., kur i mungojnë aparataturat tv), të cilat e bëjnë të qartë kontekstin e dialogut dhe e lehtësojnë kuptimin global të materialit të paraqitur.

Në marrëdhëniet e mësuesit me grupin është thelbësore për ecurinë dhe suksesin e procesit, vendosja e një klime e qetë, bashkëpunimi nxënës-nxënës dhe nxënës-mësues. Kjo klimë besimi dhe respekti reciprok vendoset përmes komunikimit të vazhdueshëm për të njohur interesat, problemet, nevojat dhe vështirësitë. Mësuesi të mos kritikojë mospakeset e nxënësve të vet, gabimet t'i konsiderojë si një fazë e pashmangshme dhe tranzitore të procesit të nxënies, duke ndërhyrë vetëm në momente të përshtatshme e duke bërë përgjithësimin kur është e mundshme, por pa ndërprerë fluksin komunikues. Të nxitën përpjekjet e nxënësve për t'u shprehur në gjuhën e huaj.

Gjatë vitit të parë qasja didaktike do të jetë kryesisht gojore për të shmangur probleme vështirësie lidhur me shqiptimin dhe grafinë e fjalëve apo të frazave në gjuhën italiane. Më pas, kur nxënësit tregojnë se e kanë asimiluar shqiptimin e teksteve gojore të dhëna, kalohet në fazën e leximit, e cila do të përqendrohet kryesisht në paraqitjen në formë të shkruar të teksteve të nohura me gojë. Nga leximi mund të kalohet më tej në veprimtari kopjuese apo rishkruese të fjalëve të veçanta me gjurmë, duke mbushur vendet bosh brenda fjalës apo brenda frazave të njohura më parë.

VII. Struktura sintetike e programit

35 javë x 2 orë = 70 orë

Mësime të reja	62 orë
Përsëritje gjatë vitit	6 orë
Detyra kontrolli	2 orë
<i>Gjithsej</i>	<i>70 orë</i>

Mësime të reja (62 orë). Mësuesi është i lirë që të planifikojë vetë mësimin, numrin e orëve që nevojiten për secilën njësi didaktike në varësi të nivelit të nxënësve me të cilët punon.

Përsëritje gjatë vitit (6 orë). Gjatë përsëritjes së njohurive të fituara deri në atë pikë, të synohet rimarrja dhe ngulitja e funksioneve, nocioneve e strukturave më të rëndësishme, si dhe përdorimi i tyre në situata të tjera.

Detyra kontrolli (2 orë). Detyrat me shkrim nuk kanë qëllim vetëm një vlerësim të njohurive, por përmes tyre të synohet edhe njëfarë ndërgjegjësimi paraprak i nxënësit për shkallën e arritjeve individuale, gjë që do t'i shërbente motivimit të tij për të nxënë gjuhën italiane.

VIII. Kriteret për hartimin e tekstit.

Teksti “Gjuha italiane-3” për shkollat nëntëvjeçare do të jetë fryt i programit të lëndës “Gjuha italiane për klasën e tretë” të CF.

Ndryshe nga vitet e kaluara, teksti “Gjuha italiane-3” do të jetë një teksti i përbërë nga dy pjesë: nga libri i nxënësit dhe fletorja e punës, si dhe kasete për aspektin e të dëgjuarit.

Për hartimin e tekstit “Gjuha italiane-3” kërkohet të realizohen dhe të respektohen parimet dhe kriteret e mëposhtme:

Teksti “Gjuha italiane-3” të respektojë programin e hartuar për këtë klasë.

Përzgjedhja e materialit bëhet në përputhje me një publik specifik dhe mjedis specifik, pra nxënës të grup-moshës 8-9 vjeç. Prandaj, metoda t'u përshtatet kërkesave dhe interesave të kësaj grup-moshe. Nëpërmjet tij nxënësi zbulon, vepron dhe bashkëvepron.

Autorët janë të lirë të vendosin temat atje ku ato mundësojnë në përshtatje me qëllimet mësimore, gjuhësore, strukturore, kulturore dhe ndërthurjen e tyre.

Për të realizuar integrimin, është e nevojshme që teksti të jetë i ndarë me njësi didaktike dhe me linja të caktuara që realizojnë objektiva dhe qëllime të larmishme mësimore. Materiali të jetë tërheqës, me karaktere (personazhe) të pëlqyeshme nga nxënësit e kësaj moshe, me ngjyra dhe figura të shumëllojshme, të cilat mundësojnë nxitjen e nxënësve në nxënien e gjuhës italiane. Veptimtaritë të jenë të tilla që të nxisin

imagjinatën dhe kreativitetin e nxënësve. Nëpërmjet mjeteve të mësipërme autorët të mbajnë përasysht futjen e elementeve të kulturës dhe të civilizimit të vendit përkatës të gjuhës italiane, me anë të së cilës t'i mundësojë nxënësit njohjen me këtë kulturë.

Këshillohet që aparati pedagogjik i çdo mësimi të shoqërohet me rubrikat përkatëse, të cilat pasyrojnë integrimin e aftësive gjuhësore, duke shmangur nga teksti modelin e aparateve pedagogjike që kanë pamjen e një grupi pyetjesh të renditura njëra pas tjetrës dhe të ndara prej njëra-tjetrës. Planifikimi i veprimtarive mësimore të tilla, si: të lexuarit, të folurit, të shkruarit e të dëgjuarit, të jenë pjesë përbërëse e këtij teksti të integruara në vetvete dhe në çdo orë mësimi si në pjesën teorike të temave të veçanta, ashtu edhe në pjesën praktike. Veprimtaritë në tekst ndërtohen duke patur përsysht përdorimin e figurave, të këngëve të shoqëruara me veprime, ngjyrosjes, lojës me letra ngjitëse, dialogjeve të thjeshta etj.

Teksti të përmbajë:

- ushtrime me shkrim nëpërmjet historive, përrallave të shkurtra,
- komente të thjeshta për figura, me etiketa;
- veprimtari që forcojnë bashkëpunimin dhe jo konkurrencën;
- tabela vetëvlerësuese që e lejojnë fëmijën të vetëqortohet.

Teksti të jetë i shoqëruar me libër mësuesi.

Rimarrja dhe riciklimi i njohurive, si një parim didaktik, të jetë pjesë e mësimave që do të përbëjnë këtë tekst, për lidhjen dhe përfortimin e njohurive të dhëna në mësimet e mëparshme. Këshillohet një mësim përsëritës pas çdo cikeli deri në 4 mësimet të reja.

Kërkohet që teksti “Gjuha italiane-3” të jetë një mjet që zhvendos veprimtarinë e mësuesit gjatë mësimdhënies, nga një mësimdhënie me mësuesin në qendër, në një mësimdhënie me nxënësin në qendër. Të ketë baraspeshë ndërmjet veprimtarive individuale dhe kolektive. T'i përshtatet zhvillimit emocional të nxënësve.

Një ndihmesë të madhe në përvetësimin e gjuhës së huaj është funksionimi i të mësuarit të fjalëve të reja me të gjitha elementet bazë të fjalës apo të shprehjeve duke realizuar trajtimin fonetik mbas çdo mësimi dhe kuptimet gramatikore, leksikore mbas çdo kapitulli.

Punët me shkrim nuk janë të detyrueshme si përbërëse e çdo ore mësimore, por të para si veprimtari që i përfshijnë nxënësit në veprimtari të gjera zbatuese dhe krijuese.

Numri i faqeve 120 A4, me katër ngjyra. Format 260 x 200 mm.